

Robert Elsie
Përkthejmë shqiptarët, por nuk shiten...

Një nga përkthyesit më të njohur të autorëve shqiptarë në gjuhën angleze dhe gjermane, Elsie nuk mund të humbte jo vetëm Panairin e 7-të të librit, por as edhe debatin e Edicionit të Dytë të Takimit të Përkthyesve dhe Botuesve të Huaj, të organizuar nga MKRS. Në intervistën dhënë për gazetën "Metropol", Elsie prezanton opinionet e tij mbi ecurinë e librit shqiptar në Evropë si edhe mbi përkthimin, emrat më të njohur të letrave shqipe në tregun e huaj si edhe disa nga shkaqet, që pengojnë përhapjen e librit shqip në botë.

Gjatë takimit u hodh ideja mbi një bashkëpunim të përkthyesve të huaj që përkthejnë kryesisht nga shqipja në gjuhë të huaj me ata shqiptarë, për një cilësi më të lartë në këtë drejtim...

Në parim, besoj se është një ide e mirë. Gjatë takimit u sollën shembuj të tillë. U soll një shembull mbi një vepër të Luljeta Lleshanakut, një poete të cilën e vlerësoj shumë, por ku vihen re gabime në përkthim. Ajo që nuk duhet të ndodhë është përkthimi nga shqiptarë në gjuhë të huaja, kur nuk i njohin mirë ato, pasi kjo ul jo vetëm cilësinë e veprës në fjalë, por edhe prestigjin e letërsisë shqiptare në përgjithësi.

Sa i ngushtë ka qenë dhe është kontakti juaj me letërsinë shqiptare?

Unë jam në kontakt të ngushtë me letërsinë shqiptare, por ju them sinjerisht, është shumë e vështirë për të lexuar gjithçka. Shfletoj shumë dhe kur shoh diçka interesante dhe gjej kohën e duhur, ulem dhe lexoj me shumë vëmendje. E vërteta është se shumë pak arrij të lexoj, në krahasim me numrin e librave që marr me vete kur largohem nga Shqipëria.

Ju keni përkthyer disa autorë shqiptarë në gjuhë të huaj, si ka qenë ecuria në treg e tyre?

E vërteta është se asnjëherë nuk i kam parë në këtë aspekt librat që kam përkthyer, por mund t'u them se asnjë prej tyre nuk ka patur një sukses komercial. Besoj se një faktor i rëndësishëm në këtë aspekt është dobësia e madhe që ka në sektorin e shpërndarjes. Këto libra nuk kanë arritur të hyjnë në tregun anglishtfolës. Madje, edhe libra të botuar në Nju-Jork, nga Gjonlekaj, që ka një emër shumë të mirë në treg, nuk kanë mundur të lexohen nga publiku i gjerë. Problemi nuk qëndron te cilësia e veprave, pasi ata ose nuk njihen ose nuk gjenden. Disa prej tyre nuk kanë as ISBN, ky fakt apo edhe probleme të tjera teknike e frenojnë shumë njohjen dhe leximin e librit. Mua më vjen keq se punoj shumë për një përkthim, por më pas libri nuk shpërndahet si duhet në treg. Ka edhe një problem tjetër se në disa raste librat shqiptarë përkthehen nga gjuhë të tjera, si frëngjisht dhe italisht, pasi nuk ka përkthyes nga gjuhë të tjera që njohin gjuhën shqipe, kryesisht nga shqipja në anglisht.

A besoni se letërsia shqipe njihet aq sa duhet në tregun ndërkombëtar?

Kam përshtypjen se jo. Madje, edhe Kadare njihet në Francë, pjesërisht Gjermani, Spanjë, ndërsa në botën anglishtfolëse nuk njihet, pothuajse fare. Autorë të tjerë shqiptarë që njihen në disa

vende të Evropës janë Bashkim Shehu, Luan Starova, Besnik Mustafaj, por, sidoqoftë janë pak. Kam përshtypjen se edhe Kongoli do të ketë sukses.

Besoni se veprat që përkthehen në gjuhë të huaj janë të gjitha cilësore?

Besoj se ka edhe vepra të tjera që duhet të ishin përkthyer, por kjo është çështje individuale. Përkthyesi trajton një vepër që i pëlqen apo i duket interesante atij vetë. Ky është një kriter. Por edhe njohjet personale apo faktorë të tjerë ndikojnë në këtë aspekt. Ka p.sh., disa poetë shumë të mirë, por që unë e kam patur shumë të vështirë t'i përkthej. Personalisht, përpiqem t'i prezantoj botës autorë të njohur shqiptarë, pasi një autor, i cili është i panjohur, nuk përfaqëson letërsinë shqiptare në masën e duhur, ndërkohë që unë jam i interesuar të prezantohen emrat më të njohur të saj. Kjo nuk përjashton përkthimin e autorëve të rinj apo të panjohur dhe, sidomos po të kihet parasysh, që ata të brezit të ri janë të panjohur në përgjithësi.

A jeni duke përkthyer diçka nga letërsia shqiptare në këtë periudhë?

Kam përfundur përkthimin në anglisht të "Lahuta e Malësisë" të Fishtës, pas tre vitesh pune. Në dhjetor do të publikohen poezi të Visar Zhitit, në Los Anxhelas, poezi të Azem Shkreli që do të publikohen në Nju-Jork. Ndërkohë janë botuar "Fjalori historik i Shqipërisë" dhe ai për Kosovën, të cilët japin një informacion më të plotë enciklopedik për popullin, kulturën dhe traditën shqiptare. Gjithashtu besoj se, edhe "Eposi i Kreshnikëve", një botim në anglisht dhe në shqip, i botuar para një viti të mbetet në këtë stad, pasi edhe botuesi më ka thënë se nuk ka ecur si duhet në treg, por mos harrojmë se është vetëm viti i parë që qarkullon. Por, preokupimi im kryesor është të gjej një botues për veprën e Fishtës, pasi "Lahuta e Malësisë" është një vepër, që nuk besoj se do të shitet shumë.

Intervistoi: Leonard Olli

[Botuar në gazetën *Metropol*, Tiranë, nr. 156, 7 nëntor 2004. Published in the Albanian newspaper *Metropol*, Tirana, no. 156, 7 November 2004]